



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Nr. 1566/3 Prot.

Tiranë, më 26.09.2024

Lënda: Kërkesë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të datës 30.09.2024

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Tiranë

Në zbatim të Kreut II pika 13 e VKM nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” i ndryshuar, dhe Lidhjes 1, Shtojca 1 e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 269 datë 11.08.2020 i ndryshuar, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim “FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK”.

Njoftimi ju dërgohet edhe në format elektronik (CD) si dhe në adresën zyrtare të emailit – info@app.gov.al.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
SOKOL ISMAILI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Tiranë** njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **“RESTAURIMI I MUZEUT ARKEOLOGJIK KORÇË”**, Monument Kulture i kategorisë së I-rë.
3. Llojin e punës: **“RESTAURIMI I MUZEUT ARKEOLOGJIK KORÇË”**
4. Fondi limit i procedurës së konkurrimit është **11.545.000** (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë) **lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës **180** (njëqind e tëdhjetët) ditë, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **jo më pak se 15 ditë nga publikimi** i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **15.10.2024 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimit publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: www.iktk.gov.al në Rubrikën “Rreth nesh/Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e plotësisht të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë **15.10.2024 ora 11:00** në Autoritetin Kontraktor/Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, kati II, salla e Bibliotekës, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.